



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/I92-2 Prot.
Nr. Dok. 202401446/2

Tiranë 11/12/2024

Lënda: *Rekomandim për vënien në funksionim dhe përmirësimin e standardeve të Strehëzës Emergjente për viktimat e dhunës në familje, Roskovec.*

BASHKISË

ROSKOVEC

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE

TIRANË

SHËRBIMIT SOCIAL SHTETËROR

TIRANË

Të nderuara/ nderuar,

Avokati i Popullit, si një institucion i pavaruar, në ushtrimin e funksioneve të tij sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, tregon kujdes të veçantë lidhur me promovimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke përfshirë dhe të drejtat e grave dhe vajzave, si pjesë e pandashme e të drejtave të njeriut.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në zbatim të misionit të tij por edhe në frymën e Konventës së Stambollit¹, vijon ta mbajë në vëmendje të veçantë adresimin e çështjes së dhunës ndaj grave e dhunës në familje, përmes vlerësimeve të vazhdueshme, jo vetëm të situatës në tërësi dhe masave të ndërmarra nga institucionet shtetërore qendrore e vendore për parandalimin e këtij fenomeni, mbrojtjen e viktimave/të mbijetuarave/mbijetuarve, ndëshkimin e dhunuesve si dhe hartimin e politikave të integruara, por edhe duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në **vlerësimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara emergjente apo afatgjata të ngritura pranë njërive të vetëqeverisjes vendore**, të cilat duhet të funksionojnë duke zbatuar jo vetëm standardet kombëtare në fuqi, por edhe duke konsideruar standardet ndërkombëtare, sidomos ato të theksuara në Konventën e Stambollit.

Në këtë kuadër bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”², (i ndryshuar), përfaqësuese të Avokatit të Popullit, me detyrë ndihmëskomisionere të Seksionit të Përgjithshëm, në datën 30.09.2024, kryen një inspektim në *Strehëzën Emergjente për viktimat e dhunës në familje, të Bashkisë Roskovec*.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje gra dhe fëmijë, të cilat strehohen dhe marrin shërbime në këtë strehëz, në zbatim të Ligjit Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 505, datë 13.07.2011 “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje, në qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike” dhe Udhëzimit Nr.744, datë 15.11.2019 të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Standardet minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (Strehëzat emergjente)”

Pasi shqyrtoi informacionin nga inspektimi i realizuar, Avokati i Popullit ka detyrimin ligjor, t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare të këtij monitorimi.

¹ Ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Ligjin Nr.104/2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”

² Avokati i Popullit apo personat e autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim e pa autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në burgje, në vende ku policia ose prokuroria mbajnë persona të shoqëruar, të ndaluar apo të arrestuar, (të paraburgosurit), në reparte apo institucione shtetërore, spitale psikiatrike, në azile, në shtëpi fëmijë, si dhe në çdo vend tjetër kur ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise.

Çdo lloj korrespondence e këtyre personave me Avokatin e Popullit nuk duhet të pengohet ose të kontrollohet.

Objektivat e inspektimit:

- Vlerësimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit, në zbatim të legjislacionit në fuqi.
- Vlerësimi i ambienteve dhe infrastrukturës.
- Respektimi i të drejtave të personave (gra edhe fëmijë), të cilat/cilët janë akomoduar në këtë strehëz emergjente, në zbatim të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje.

Metodologjia:

Metodologjia e inspektimit ka konsistuar në :

- *Së pari*, monitorimin e zbatimit të standardeve ligjore të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për qendrat rezidenciale afatshkurtra për viktimat e dhunës në familje³.
- *Së dyti*, zhvillimin e bisedave paraprake me përgjegjësen/koordinatoren dhe punonjëset e Strehëzës, informacion i cili është hedhur në një formular standard për inspektimin.
- *Së treti*, monitorimin e mjediseve dhe kushteve të institucionit ku ofrohen shërbime për personat e dhunuar në familje (gra dhe fëmijë).
- *Së katërti*, komunikimi me gra dhe fëmijë, përfituese/përfitues të shërbimeve të përkujdesjes, që në momentin e inspektimit mund të jenë të akomoduar në *Strehëzën Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje, Roskovec*.

Profili i Strehëzës Emergjente për viktimat e dhunës në familje, Roskovec

Në momentin e inspektimit Strehëza nuk ishte funksionale. Prej mëse dy vitesh nuk ka patur raste të dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore, të strehuara në këtë strehëz.

Bazuar në bisedën e drejtëpërdrejtë me Koordinatorin Vendor kundër dhunës në familje dhe Drejtoreshën e Shërbimit Social të Bashkisë Roskovec, si dhe dokumentacionit, që na u vu në dispozicion, rezulton se:

Strehëza Emergjente për viktimat e dhunës në familje, është ngritur në Bashkinë e Roskovecit, me Vendimin Nr. 67, datë 26.09.2017 të Këshillit Bashkiak, si një shërbim emergjent, një detyrim ky i parashikuar në Ligjin Nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (LDHF), të ndryshuar, Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”,

³ Në përputhje me Udhëzimin nr.744, datë 15.11.2019, "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat/ të mbijetuarat/it e dhunës me bazë, gjinore dhe dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurta) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente), Shih:<https://inspektoriaipunes.gov.al/wp-content/uploads/2021/06/akt-18-Udhezim-744-dt-15.11.2019-STANDARTET-MINIMALE-QENDRAT-EMERGJENTE-1.pdf>

Ligjin Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet e tjera nënligjore për shërbimet e përkujdesit shoqëror.

Qëllimi i ngritjes së kësaj strehëze ishte strehim i sigurt për viktimat e dhunës në familje deri në 72 orë për viktimat e dhunës në familje, gra dhe fëmijët e tyre, duke ofruar mbulim të nevojave me veshmbathje, ushqim, këshillim ligjor dhe psiko-social.

Strehëza Emergjente për viktimat e dhunës në familje dhe shërbimet në këtë strehëz deri në momentin e funksionimit janë mbuluar me fonde të Bashkisë Roskovec.

Strehëza menaxhohet nga Shërbimi Social i Bashkisë Roskovec. Koordinator Vendor kundër Dhunës në Familje (KVDH) ka si detyrë kujdesin për shërbimet në strehëz dhe nëse konsiderohet e nevojshme çdo punonjësi i Qendrës Sociale Komunitare vjen në ndihmë të tij.

Edhe pse nga viti 2022 deri në momentin e inspektimit, Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Bashkisë Roskovec ka menaxhuar rreth 40 raste, rezulton se për të njëjtën periudhë kohore nuk ka patur viktima të dhunës në familje apo dhunës me bazë gjinore të strehuar në Strehëz. Shumica e rasteve pas pajisjes me UMM/UM kanë qendruar në banesat e tyre, duke qenë se sipas parashikimit ligjor të LDHF, dhunuesit janë larguar nga banesa. Tre nga këto raste janë adresuar në Strehëzën Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje, për marrjen e shërbimeve afatgjata.

Për periudhën në të cilën strehëza ka qenë funksionale, ka patur bashkëpunim të mirë me Komisariatit e Policisë dhe Qendrën Shëndetësore. Këto dy institucione janë dhe anëtare të MKR të Bashkisë Roskovec.

Monitorimi i shërbimeve në Strehëz deri në momentin e funksionimit është bërë nga Drejtoria e Shërbimit Social të Bashkisë Roskovec.

Ngritja e strehëzave/qendrave për viktimat e dhunës në familje është e parashikuar në Konventën e Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje”, si një shërbim mbështetës i specializuar, në Nenin 23, ku shprehimisht thuhet se: “*Palët marrin masat e nevojshme legjislative ose masa të tjera për të parashikuar ngritjen e strehave të përshtatshme, lehtësisht të aksesueshme e në numër të mjaftueshëm, për të ofruar strehim të sigurt dhe për të përdorur përjasje proaktive ndaj viktimave, veçanërisht grave dhe fëmijëve të tyre.*”, si dhe në Ligjin Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (i ndryshuar), neni 7, pika 4.⁴

⁴ Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë: ngritjen e qendrave sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to; koordinimin e punës me qendrat ekzistuese, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse dhe qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje;

Shërbimet e Strehimit në strehëzat emergjente për viktimat e dhunës në familje⁵, duhet të funksionojnë në bazë të standardeve, procedurave dhe politikave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sipas legjislacionit për sistemin e mbrojtjes shoqërore, dhe veçanërisht bazuar në Udhëzimin Nr.744, datë 15.11.2019 të Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Standardet minimale të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (Strehëzat emergjente)”.

Numri i përfitueseve/përfituesve nga shërbimet e ofruara

Përfitueset/përfituesit e drejtpërdrejtë janë gra/vajza dhe fëmijët e tyre, të cilat përjetojnë situata vulnerabiliteti dhe rreziku nga dhuna në familje me të gjitha format e saj, të 4 njësive administrative të Bashkisë Roskovec dhe qytetit të Roskovecit.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë përfituese/përfitues që të ishte akomoduar në strehëz, duke qenë se strehëza ishte jo funksionale.

Numri total i përfitueseve/përfituesve për shërbimet në Strehëz për periudhën 2019-2022, në të cilën strehëza ka qenë funksionale, ka qenë një grua me dy fëmijët e saj të mitur (një vajzë dhe një djalë) dhe një person i pastrehë.

Asnjë nga përfitueset/përfituesit nuk kanë qenë anëtare të komunitetit rom/egjyptian apo persona me aftësi të kufizuara.

Përfituesit/përfitueset kanë qëndruar deri në 48 orë në strehëz.

Ndërsa numri i rasteve të trajtuara me shërbime të tjera nga MKR i Bashkisë Roskovec për periudhën 2019- shtator 2024 ka qenë 97 viktima të dhunës në familje.

Për periudhën kur qendra nuk ka qenë funksionale, nga viti 2022 deri në shtator 2024, vetëm 3 raste janë adresuar për mbështetje afatgjatë në Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje.

Sipas informacionit të vënë në dispozicion dhe intervistës me përfaqësues të Drejtorisë së Shërbimit Social, numri i rasteve në nevojë për strehim emergjent ka rënë, pas miratimit të ndryshimeve në vitin 2020, që iu bënë Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, duke qenë se sipas ligjit parashikohet largimi i dhunuesit nga banesa. Shumica e rasteve kanë qëndruar në banesat e tyre, sipas vendimeve për lëshimin e UMM/UM nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe në disa raste duke ndarë të njëjtën banesë me dhunuesin.

⁵ Nga informacionet që Avokati i Popullit disponon, rezultojnë se në të gjithë vendin aktualisht ka 23 Strehëza Emergjente të ngritura prane bashkive dhe 2 Qendra Kombëtare për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe menaxhimin e rasteve të dhunës seksuale.

Referuar dokumentit të Planit Social të Bashkisë Roskovec 2024-2026, *“Akomodimi në shërbimin emergjent raportohet të jetë një sfidë në këtë bashki. Edhe pse ligji prashikon largimin e dhunuesit nga banesa, kjo masë pothuaj nuk zbatohet”*⁶

Gjatë kësaj peridhe nuk ka patur asnjë rast që të ketë përfituar nga programet sociale të strehimit⁷, duke qenë se Bashkia Roskovec nuk ka patur banesa sociale. Aktualisht Bashkia Roskovec është në proces të aplikimit dhe ndërtimit të banesave sociale nga Enti Kombëtar i Banesave.

Gjithashtu nuk ka patur përfituese të bonusit të qerasë, duke qenë se banesat që ofrohen nga qytetarët për dhënie me qera nuk plotësojnë kriteret e kërkuara për ofrimin e këtij shërbimi.

Për rastet e trajtuara në strehëz nuk na u vu në dispozicion dosje fizike e përfituesve.

Burimet njerëzore

Strehëza menaxhohet nga Shërbimi Social i Bashkisë Roskovec. Koordinatorin Vendor kundër Dhunës në Familje (KVDH) ka si detyrë kujdesin për shërbimet në strehëz dhe nëse është e nevojshme çdo punonjës i Qendrës Sociale Komunitare vjen në ndihmë të KVDH.

Shërbimi psiko-social për gratë/viktimat e dhunës në familje, për rastet të cilat nuk akomodohen në strehëz, jepet aktualisht pranë ambienteve të Qendrës Social Komunitare të Bashkisë Roskovec. Rastet të cilat kanë nevojë për këshillim dhe ndihmë ligjore, referohen pranë Zyrës së Ndihmës Ligjore Fier.

KVDH ka marrë disa trajnime nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për çështje të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, por shprehet se ka nevojë për trajnime të mëtejshme.

E drejta e ankimit dhe monitorimi i rasteve

Në strehëz në momentin e inspektimit konstatuam mungesën e afishimit nëpër mure të të drejtave dhe detyrimeve të përfituesve dhe të kutisë së ankesave.

Problematikat e konstatuara:

-Ambientet e strehëzës ishin të mbyllura prej mëse dy vitesh, të pa ajrosura, me lagështirë dhe të papastra.

-Pajisjet në tualet ishin jashtë funksionit.

⁶ Fq. 19 Plani Social i Bashkisë Roskovec.

Linku: <https://bashkiaroskovec.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/Plani-Social-2024-2026.pdf>

⁷ Sipas Ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social në Republikën e Shqipërisë”, viktimat e dhunës në familje janë një nga subjektet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit, që duhet të ngrihen prane çdo njësie të vetëqeverisjes vendore.

- Në strehëz ishte e ndërprerë energjia elektrike.
- Mungonte një rregullore e funksionimit të Strehëzës.
- Mungonte një dokument ku të jenë të shprehura të drejtat dhe detyrimet e përfituesve.
- Nuk ka raporte të mëparshme apo informacione lidhur me menaxhimin e strehëzës.
- Nuk ka dosje fizike të përfituesve.

Në këto kushte Strehëza Emergjente për viktimat e dhunës në familje të Bashkisë Roskovec, nuk mund të kryejë funksionet e ofruesit të shërbimit emergjent për viktimat e dhunës në familje.

Fakti se MKR i Bashkisë Roskovec, gjatë periudhës 2019-shtator 2024 ka menaxhuar 97 raste të dhunës në familje dhe sfidë mbetet largimi i dhunuesve nga banesa, tregon qartë për nevojën e strehimit të sigurt emergjent dhe afatgjatë si dhe mbështetjes së viktimave me programe të strehimit social. Qëndrimi në të njëjtën banesë të dhunuesit dhe viktimës përbën shkak për rëndimin e situatës së dhunës me të gjitha format e saj, duke sjellë në të njëjtën kohë pasoja të rënda në shëndetin mendor dhe emocional të viktimave deri në raste fatale të vrasjes.

Avokati i Popullit kupton faktin që menaxhimi i shërbimeve emergjente është sfidues dhe ka nevojë për rritjen e efikasitetit dhe nga ana tjetër për përdorimin e burimeve në mënyrë të përshtatshme. Por vlerëson se funksionet e strehëzës duhet të realizohen në mënyrë thelbësore, ashtu siç përcaktohet në ligj dhe standardet e miratuara për këtë qëllim.

Problematika e konstatuar gjatë inspektimit në Qendrën Emergjente për viktimat e dhunës në familje Roskovec, si dhe bazuar në publikimin “Hartëzimi i Shërbimeve Sociale në Shqipëri”⁸, se strehëzat emergjente mungojnë në Qarkun e Fierit, çojnë në nevojën për të rishikuar nga ana Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbështetjen financiare nëpërmjet mekanizmit të Fondit Social për këtë tipologji shërbimi me bazë qarku, në mënyrë që shërbimi emergjent apo afatgjatë për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje të ofrohet 24 orë në 7 ditës e javës pa ndërprerje, në përputhje me standardet e miratuara për këtë qëllim.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe

⁸ Fq.7, gërma j) e pikës III.1 të publikimit “Hartëzimi i Shërbimeve Sociale në Shqipëri”
 Link: https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2023-11/mapping_alb_web.pdf

nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

REKOMANDON:

Marrjen e masave të menjëhershme nga Bashkia Roskovec për:

1. Vënien në funksionim të Strehëzës Emergjente për Viktimat e Dhunës në Familje Roskovec, në mënyrë që të vijojë ecuria normale, nëpërmjet rikonstruksionit të ambientit ekzistues, ose transferimin në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me standardet e miratuara për këtë qëllim.
2. Deri në përfundimin e rikonstruksionit të Strehëzës ose gjetjes së ambienteve të tjera të përshtatshme, të sigurohet strehimi i viktimave të dhunës, në strehëzat apo qendrat që menaxhohen nga Bashkitë e tjera të afërta, duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me këto bashki, me qëllim vijimësinë e shërbimit të emergjencës dhe marrjen e shërbimit pa pengesë nga personat në nevojë emergjente strehimi, për shkak të dhunës me bazë gjinore ose dhunës në familje.
3. Përgatitjen e rregullores së funksionimit të brendshëm të Strehëzës, duke saktësuar mirëfunksionimin e shërbimit emergjent, në të dhe në të gjithë dokumentat e tjera. Në rregullore të reflektohen të gjitha ndryshimet ligjore të viteve të fundit, si dhe duke i përafëruar edhe me standardet ndërkombëtare të funksionimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara. Rregullorja e funksionimit të Strehëzës, duhet të përgatitet edhe me një gjuhë të përshtatshme e të kuptueshme për përfitueset e shërbimeve të strehëz dhe më pas duhet të afishohet në mure, në vende të dukshme të ambienteve ku ofrohet shërbimi i emergjencës.
4. Në vazhdimësi, për çdo rast që do të marrë shërbim në strehëz të mbahen dosje të përfituesve të pajisura me kod unik idendifikimi, në përputhje me standardet e miratuara për këtë qëllim.
5. Përfshirjen në Projekt Buxhetin Afatmesëm 2025-2027 të Bashkisë, të kostove të nevojshme për mirëfunksionimin e shërbimit të Strehëzës.

Marrjen e masave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për:

6. Mundësimin e ngritjes së Qendrave/ Strehëzave Emergjente nëpërmjet Mekanizmit të Fondit Social, me qëllim mbështetjen me shërbime të specializuara emergjente dhe afatgjata të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, sipas standardeve të miratuara, në nivel Qarku.
7. Trajnimin e vazhdueshëm të Koordinatorit Vendor kundër dhunës në familje dhe punonjësve të tjerë të shërbimit social të Bashkisë Roskovec që menaxhojnë rastet e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje,

lidhur me legjislacionin kundër dhunës në familje, zbatimin e standardeve, menaxhim rasti, etj.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERE

Vilma SHURDHA